



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunes nxjerr:

### VENDIM

### PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2024/2025

#### Neni 1

I Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2024/2025 të ndahen 400 (katërqind) bursa dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

#### Neni 2

OBLIGOHET, Drejtorati për Arsim që menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi të përgadisë Thirrjen publike për aplikim, konform kritereve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22594 të dates 28.04.2023 dhe të njëjtën ta publikojë në faqen zyrtare të Komunës, në njërën nga gazetaret ditore me tirazh të madh dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

#### Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 i këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria e subvencioneve në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

#### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 670/01-62255  
Lipjan, më 20.12.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS TË OJQ-SË PËRFITUESE PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR QENDRAT MËSIMORE QË MBËSHTESIN NXËNËSIT ROM, ASHKALI, DHE EGJIPTIAN SI DHE NXËNËS TJERË NË KOMUNËN E LIPJANIT

#### Neni 1

Me këtë Vendim, **Driton Sadiku**, Drejtori i SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontrates të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së "Voice of Roma Ashkali and Egyptians" për realizimin e aktiviteteve të projektit për qendrat mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian si dhe nxënës të tjerë, sipas Projekt- Propozimit të paraqitur sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.4-453/01-53287 të datës 24.10.2024".

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrates të OJQ-së si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ-ja "Voice of Roma Ashkali and Egyptians"

#### Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontrates të lidhur mes Komunës dhe OJQ-së të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës **Driton Sadiku** dhe Drejtorati për Arsim.

1Nr. 112/02-59563  
Lipjan, më 02.12.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

### Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft - Rregullores për rrugët lokale dhe trotuaret në Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Burim Rrustemi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues,
2. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Rafete Rektoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare,
4. Bujar Curri, Drejtorati për Inspektorat, anëtar dhe
5. Rrahman Olluri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar,

### Neni 2 Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Draft - Rregullores për rrugët lokale dhe trotuaret në Komunën e Lipjanit, duke u bazuar në dispozitatat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri më 20.01.2025.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

### Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr.020/04-60944  
Lipjan, më 12.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Kontratës së prokurimit për furnizimin nr 613-24-11737-1-3-6/C1014 të datës 06.12.2024 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E DHURATAVE PËR FESTAT E**  
**FUNDVITIT PËR FËMIJË**

**Neni 1**  
**Përbërja**

Formohet Komisioni për pranimin e dhuratave për fëmijët për festat e fundvitit, konform dispozitave të Kontratës së prokurimit për furnizimin nr 613-24-11737-1-3-6/C1014 të datës 06.12.2024, në këtë përbërje:

1. Ismet Ahmeti, Kryesues,
2. Begzat Gërbeshi anëtar,
3. Bashkim Hyseni, anëtar

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të bëjë:

- Konstatimin e sasisë ,cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuar, të cilat duhet të dokumentohen me procesverbal lidhur me përputhshmërinë me kontratën apo urdhërblenjen.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. \_\_\_\_\_  
Lipjan, më 09.12.2024



KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1  
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e rinisë dhe kulturës në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-60370 të datës 06.12.2024, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare dhe
6. Besmir Retkoceri, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar rezervë

Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e rinisë dhe kulturës në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar konform thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-60370 të datës 06.12.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3  
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-64174  
Lipjan, më 30.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim Nr.1-020/01-60697 të datës 10.12.2024, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

### Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për ofrimin e të dhënave të nevojshme për Organizaten Holandeze CNVP sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit për studimin e fizibilitetit për ngrohjen e qytetit, në këtë përbërje:

1. Valon Pacolli, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesues
2. Jalldyze Gashi-Kallaba, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
3. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
4. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
5. Armend Aliu, Drejtorati për Infrastruktur, anëtar
6. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, anëtar
7. Izer Sinani, QKMF, Lipjan

### Neni 2

#### Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do t'i ofroj të dhënat e nevojshme në bashkëpunim me Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim që kërkohen nga Organizata Holandeze CNVP sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit për të ndihmuar me të dhëna organizaten për hartimin e studimit të fizibilitetit për ngrohjen qendrore të qytetit e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizates Holandeze CNVP.

### Neni 3

#### Zbatimi

Punët tekniko-administrative dhe punët e tjera të nevojshme për Komisionin do të kryhen nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

### Neni 4

#### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen, kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr.020/01-60697  
Lipjan, 11.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

#### VENDIM

#### MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË KOMUNËN E LIPJANIT

##### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Rregullorja për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit.

##### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Draft - Rregulloren për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit mund të dërgohen Komisionit për hartimin e Draft e Rregullores ose në email adresën [xhevahire.zeqiri@rks-gov.net](mailto:xhevahire.zeqiri@rks-gov.net), më së largu me datë 17.12.2024.

##### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 112/02-59816  
Lipjan, më 03.12.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligji Nr.08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, duke u bazuar në propozimin e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – Qendra për Punë Sociale, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I. Miratohet propozimi i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - Qendrës për Punë Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për mbështetje financiare për familjet strehuese në komunën e Lipjanit, të cilët përkujdesen për fëmijët e braktisur dhe për këtë qëllim caktohet vlera prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro) për çdo muaj për familjen që strehon dhe përkujdeset për fëmijë të braktisur.

II. Shuma e caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga pozicioni buxhetor - subvencionet dhe transferet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës.

III. Ky Vendim fillon të zbatohet nga 1 janari 2025 dhe vleni deri në marrjen e një vendimi tjetër, obligohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale përkatesisht Qendra për Punë Sociale të përgatis çdo muaj kërkesë për pagesë me raport me të dhëna të sakta për fëmijën e braktisur dhe familjen strehuese të cilëve ju lejohet pagesa e cekur në pikën 1 duke ja bashkangjitur raportit edhe dokumentet e tjera të nevojshme si kopjen e leternjoftimit, konfirmimin e llogaris bankare si dhe certifikaten e vendbanimit të personit nga familja strehuese.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - Qendra për Punë Sociale, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

V. Ky Vendim hynë në fuqi menjëher ndërsa zbatimi i këtij vendimi fillon nga 01.01.2025.

Vendimi i dërgohet:

- DSHPS-së, Qendrës për Punë Sociale
- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa
- Zyrës së Kryetarit të Komunës

INr. 400/01-61929  
Lipjan, më 18.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR NDALIMIN E NDEZJES SË FISHEKZJARRËVE DHE MJETEVE PIROTEKNIKE**  
**GJATË FESTAVE TË FUND VITIT**

**Neni 1**

1. Me këtë Vendim, ndalohet ndezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit në hapësirat publike të komunës së Lipjanit si dhe në zonat e banuara përveq në hapësirën e tregut të gjelbërt që gjendet në rr. "Xhavit Kozhani" në Lipjan.

2. Ndalimi i ndezjes së fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike bëhet më qëllim të mbrojtjes së ajrit dhe mjedisit nga ndotja si dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

**Neni 2**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtorati i Inspeksionit të Komunës së Lipjanit dhe Stacioni policor në Lipjani.

1Nr. 352/01-62356  
Lipjan, më 20.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR**  
**SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,520.00€**, (nëntë mijë e pesëqindë e njëzet euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-59447 e datës 02.12.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 34 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin nëntor të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast  $34 \times 280 = 9,520.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024 pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

**Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-59447  
Lipjan, më 03.12.2024

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për qendrat mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian si dhe nxënës tjerë Nr.4-453/01-53295 të datës 24.10.2024 si dhe Rekomandimin e Komisionit Vlerësues Nr.01-453/01-59357 të datës 29.11.2024, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR QENDRAT MËSIMORE QË MBËSHTESIN NXËNËSIT ROM, ASHKALI, DHE EGJIPTIAN SI DHE NXËNËS TJERË NË KOMUNËN E LIPJANIT

#### Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **25,000.00 €** (njëzetë e pesë mijë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në "Voice of Roma Ashkali and Egyptians" nga Lipjani për realizimin e aktiviteteve të projektit për qendrat mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian si dhe nxënës" sipas Projekt- Propozimit të paraqitur sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.4-453/01-53287 të datës 24.10.2024.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për projektin qendrat mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian si dhe nxënës në Komunën e Lipjanit

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-ja "Voice of Roma Ashkali and Egyptians"	25,000.00 €
	Shuma Totale	<b>25,000.00 €</b>

#### Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 të Drejtoratit për Arsim.

#### Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

#### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-53295 /2  
Lipjan, më 02.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Priljenò: 17.12.2024		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-030/01-61777		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së **Lipjanit**, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

1. Me këtë Vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së **Lipjanit**
2. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data **01 janar 2025**.
6. Vendimi u dërgohet të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet, sipas Shtojcës 1, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së Kryeministrit.

Kryetari i Komunës  
**Imri Ahmeti**



**Shtojca e treguesit: Lista e shërbimeve administrative të thjeshtuara**

**Komuna: LIPJANIT**

Nr.	Emri i Shërbimit	Emri i dokumenteve që nuk kërkohen më për marrje të shtërbimit
<b>DREJTORATI PËR ADMINISTRATË</b>		
1	Vërtetimi për mbajtës të familjes	Kopja e letërnjoftimit
2	Vërtetim për shtesa fëmijore	Çertifikata e martesës
3	Çertifikata e bashkësisë familjare	Kopja e letërnjoftimit
4	Korigjim e shënimeve në regjistrat e gjendjes civile	Kopja e letërnjoftimit
5	Kërkesa për çajmerim të vendbanimit	Kopja e letërnjoftimit
6	Ekstrakt i lindjes	Kopja e letërnjoftimit
7	Certifikatë e lindjes	Kopja e letërnjoftimit
8	Certifikata e Shtetësisë	Kopja e letërnjoftimit
<b>DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA</b>		
9	Vërtetim se janë kryer obligimet e Tatimit në pronë	Kopja e letërnjoftimit
10	Pages e taksës për automjete motorike	Vertetim per kryerjen e obligimeve tatimore
<b>DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI</b>		
11	Pëlqim për ngritjen e serrave në tokën e punueshme	Vërtetimin e kryerjes së obligimeve ndaj tatimit mbi pronën
12	Vërtetim që merret me veprimtari blegtorale	Vërtetimin e kryerjes së obligimeve ndaj tatimit mbi pronën
13	Vërtetim si dëshmi për prodhues bujqësor i drejtpërdrejt	Vërtetimin e kryerjes së obligimeve ndaj tatimit mbi pronën
<b>DREJTORATI PËR ARSIM</b>		
14	Kërkesa për aplikim për bursa studentore	Ekstrakti i lindjes Deklaratën e bashkësisë familjare
<b>DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR</b>		
15	Regjistrimi i pronësisë mbi pronën e paluajtshme në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme	Vërtetimi i tatimit në pronë
16	Ndarje e parcelave (regjistrimi)	Vërtetimi i tatimit në pronë
17	Regjistrimi i ndertesave dhe pjeseve te ndertesave	Vërtetimi i tatimit në pronë
18	Bashkimi parcelave	Vërtetimi i tatimit në pronë
19	Regjistrimi i Hipotekës në Regjistrin e të	Vërtetimi i tatimit në pronë

	Drejtave të Pronës së Paluajtshme	
20	Regjistrimi i servitutit nga Regjistri i të Drejtave në Pronat e Paluajtshme	Vërtetimi i tatimit në pronë
21	Korigjimi i të dhënave në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme	Vërtetimi i tatimit në pronë
DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE NË MJEDIS		
22	Leje Ndërtimi - Kategoria I	Vërtetimi i tatimit në pronë
23	Kërkesa për kushte ndërtimore	Vërtetimi i tatimit në pronë
DREJTORATI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM		
24	Pëlqim për shfrytëzim të rrugës për bartje të materialit ndërtimor.	Kopja e letërnjoftimit
25	Pëlqim për prerje të rruges dhe trotuareve për rregullimin e infrastrukturës.	Per rastet e kyqjes se ndonje objekti - personat juridik sjellin lejen ndertimore.
26	Pëlqim për ndalje ne rrugë	Licencen e punes
DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE		
27	Vërtetim per lirim nga shtetësia	Kopja e letërnjoftimit
DREJTORATI PËR INSPEKTORIATË		
28	Pëlqim sanitar në projekt të ndërtimit	Pëlqimi nga Kompania e Ujësjetësimit Rajonal Prishtina Vërtetimi i tatimit në pronë
29	Pëlqim për pranim teknik të lokalit afarist	Kopja e letërnjoftimit
DREJTORATI PËR RINI , SPORT DHE KULTURË		
30	Shfrytëzimi i sallave dhe i objekteve sportive	Kopja e letërnjoftimit

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Data e plotësimit të tabelës:

Vula:

Nr. i protokollit:

Pranuar më:		
Primljeno: 17.12.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-030/01-61777		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) Nr.15-400/01-53436 të datës 24.10.2024, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), Kryetari i Komunes, nxjerr:

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **16,956.52 €** (gjashtë mbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e dy cent), organizates Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) Nr.15-400/01-53436 të datës 24.1.2024 si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

2. Ndarje e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) e cila ka për qëllim implementimin e projektit për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit me paisje bujqësore.

### Neni 2

Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari lidhur me veprimet e ndërmarra konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

### Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, kategoria për subvencione dhe transfere të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari dhe transferohet në xhirollogarinë bankare nr 1708200008014285 në NLB Banka të Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW).

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari.

INr. 400/01-60728  
Lipjan, më 10.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi, Kryetari i Komunes, nxjerr:

**VENDIM  
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

1. Shuma e përgjithshme e projektit sipas Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë për projektin të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën shumë-banesore sociale në Magure është në vlerë prej **233,530.00 €** ndërsa vlera e financimit nga FKEE është 90% apo **210,177.00 €** dhe vlera e financimit nga Komuna e Lipjanit është 10% apo **23,353.00€**.

2. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **11,226.70 €** konform dispozitave të Marrëveshjes e Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi për projektin të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën shumë-banesore sociale në Magure ndërsa shuma prej **12,126.30 €** pagesa do të bëhet në vitin 2025.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, Fondi për bashkëfinancim me donatorë në xhironlogarinë bankare të Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë me nr.1110350980010125 në Procredit Bank.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Infrastruktur dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 400/01-61447  
Lipjan, më 13.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Marrëveshjen për bashkëpunim ndër-komunal në Zonën Ekonomike "Qendër" të datës 16.12.2008 si dhe Vendimit të Bordit të AZHR-së Qendër të datës 19.02.2029, Kryetari i Komunes, nxjerr:

**VENDIM  
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 5,000.00 € (pesë mijë euro), për pagesën e faturës për Agjencionit për Zhvillimin Rajonal (AZHR) në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim ndër-komunal në zonën ekonomike "Qendër" për periudhën 2024, Vendimit të Bordit të AZHR-së Qendër të datës 19.02.2029 si dhe dhe faturës nr:0005/2024-5 të datës 20.11.2024.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare nr. 1110-2993-3201-0149 në Bankën ProCredit në Kosovë.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 400/01-60/25  
Lipjan, më 05.12.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 90 e 91 të Ligjit Nr. 04/ L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera , nenit 8 paragrafi 2, pika 2 nenit 10 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

#### VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE 1NR.020/04-32090 I DATËS 05.07.2024

I. Me këtë Vendim, zëvendëohet, anëtari i Komisionit Kushtrim Jashanica me numer rendor katër (4) i caktuar sipas Vendimit për themelimin e Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve 1Nr.020/04-32090 të datës 05.07.2024 dhe në vend të tij caktohet:

**BESART ZEJNULLAHU**, Zyrtar në Drejtoratin për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim

II. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Drejtoratit për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim

Sadri Shamolli, Kryesues i Komisionit

Besart Zejnullahu, Drejtoratin për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim

1Nr.020/4-32090/2

Lipjan, më 06.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

